

Nr.prot. 28418

Tiranë 24/12 / 2015

Drejtuar: **Z. Aldrin Dalipi**
Kryetar
Këshilli Bashkiak i Tiranës

Lënda: **Dërgohet projekt - vendim dhe relacion**


I nderuar z. Dalipi,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin dhe relacionin për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”.


Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

Me respekt,

KRYETARI



Erion VELIAJ





**BASHKIA
TIRANË**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR

RELACION

PËR

SISTEMINE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 15, nenit 16 dhe nenit 32, shkronja "f" të ligjit nr.8652 dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (i ndryshuar); ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32, datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël"; ligjit Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" dhe VKB nr.49 datë 11.11.2015 "Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës", prezantojmë treguesit e paketës fiskale të vitit 2016, si më poshtë:

Ndarja administrative-territoriale e njësisve të qeverisjes vendore mundësoi jo vetëm riorganizimin ndryshe të tyre por diktoi dhe ristrukturimin institucional dhe akteve, rregullave për organizimin e funksionimin, e tyre.

Se pari, organizimi i bashkise tani me përfshinë qytetin e Tiranës por dhe ish komunat për rreth dhe për pasojë nga 41 km², sot e shtrinë aktivitetin në 1110 km² dhe me një popullsi thuajse 1 milion banorë.

Keto ndryshime po pasohen edhe me rikonceptime e ndryshime ligjore e nenligjore, si për organizimin e qeverisjes, buxhetimit, sistemit fiskal e për të gjitha fushat të cilat i kanë kaluar në funksion të këtyre njësisve.

Krahas organizimit e funksionimit institucional, legjislativi krijoi premisat e pasqyrit të ndryshimeve edhe në paketën fiskale të Bashkisë Tiranë, që në fakt do të jetë një paketë e re për shkak edhe të ndryshimeve të shumta që i janë bërë ligjit por dhe ndryshimeve konceptuale të treguesve të tij.

Ndryshimet në paketën fiskale të Bashkisë Tiranë për vitin 2016 janë për pasqyrimin e ndryshimeve ligjore por dhe për shprehjen e treguesve të taksave e tarifave vendore ndryshimeve administrative, shtrirjes gjeografike e nivelit ekonomik të njësisve përberëse të bashkisë.

Te gjitha keto ndryshime do te sherbejne si instrument per rritjen e eficencës administrative, profesionale dhe teknike të qeverisjes vendore, nëpërmjet rritjes së të ardhurave, për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët.

Paketa fiskale e Bashkise se Tiranës per vitin 2016, eshte e perbere nga taksa dhe tarifate vendore te destinuar per juridiksionin e kesaj bashkie.

Nivelet e taksave vendore, jane kryesisht te miratuara me ligj nga Kuvendi i Shqiperise, por per nevoja te qeverisjes vendore dhe ne konsultim me komunitetin, Keshilli Bashkiak ka te drejte te miratoje edhe taksa te perkohshme, qe i sherbejne nje objektivi te caktuar per permiresimin e situatave ne infrastrukture e territorin brenda juridiksionit te bashkise.

Per kuptim me te sakte te materialit te referuar me poshte, eshte e nevojshme dhe prezantimi i termave kryesore te saj, si:

“Taksapagues” është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i cili është i detyruar të paguajë një nga taksat kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.

“Taksë” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik.

“Tarifë” është një pagesë, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt apo nëpërmjet një agjenti tek administrata tatimore qendrore. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mire publike specifike të përdorur apo të drejta të dhënë.

“Agjent i taksave dhe tarifave” është subjekti i cili, sipas kërkesave të këtij ligji, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e institucioneve perkatëse të të ardhurave nga taksat dhe tarifate”.

Taksat vendore qe trajtohen ne kete pakete, jane:

- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme;
- Taksa mbi token Bujqesore;
- Taksa e truallit;
- Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV;
- Taksa e fjetjes në hotel;
- Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja;
- Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- Taksa e tabelës;
- Taksa e perkoheshme per infrastrukturen Arsimore;

Referuar ligjit nr.9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nivelet e taksave caktohen sipas ketij ligji, por keshillat bashkiakë kane autoitetin te miratojne lehtesira fiskale me nje ulje te nivelit deri ne 30% si dhe te aplikojne edhe nje rritje deri ne 10% kundrejt nivelit sipas ligjit.

Paketa fiskale e bashkise eshte nje pasqyrim i ndryshimeve ne ligjin nr.9632 date 30.10.2006, qe konsiston pergjithesisht ne :

- Berja zero e tatimit te thjeshtuar te fitimit te biznesit te vogel me xhiro deri 5 milion leke;
- Ulje e detyrimit per tatimit te thjeshtuar te fitimit te biznesit te vogel me xhiro nga 5-8 milion leke nga 7.5% ne 5% te te ardhurave;
- Konfirmimi i takses se truallit si pasuri e paluajtshme;
- Heqja e takses per zenie hapsire publike dhe rikonceptimi isaj si tarife vendore;
- Berjen zero te takses se tabelës identifikuese me siperfaqe dei ne 2 m2 dhe llogarttijen e takses per tabela mbi 2m2 me nivelin e takses reklamuese;
- Pergjysmimi inivelit te takses se ndertesve që përdoren për veprimtari prodhuese;
- Ndryshimi e detajimi i nivelit te takses se fjetjes ne hotel sipas kategorise se subjekteve akomoduese;
- Ndryshimi i nivelit te takses se ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja per parafrimin e tij me realitetin e çmimeve te tregut sipas kategorive te ndertimit e shtrirjes territorial;
- Vendosja e takses se perkoheshme për infrastrukturën arsimore;
- Vendosja e tarifës se urbanistikes si pasqyrim i sherbimeve te domosdoshme per shqyrtimin e trsajtimin e kerkses per leje zhvillimore;
- Konstituimi i tarifës per dhenie leje tregtimi te karburanteve e lendeve djegese;
- Kthim i tarifës se veterinarise;
- Vendosja e tarifës se PMNZSHH per shkak te perfshirjes institucionale.

Pershkrimi i taksave e tarifave vendore te Bashkise Tirane, paraqitet si me poshte:

I. TAKSAT VENDORE

Llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese dhe agjenti tatimor.

I.a TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

- I.a.1 Taksa mbi ndërtesat
- I.a.2 Taksa mbi tokën bujqësore
- I.a.3 Taksa mbi truallin

I.a.1 TAKSA MBI NDËRTESEN

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit (individ, person fizik apo juridik, vendas apo të huaj) përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi.

Nëse ndërtesa nuk ka dokumentacionin e pronësisë, për efekt të përlllogaritjes së detyrimit njihen të vlefshme edhe dokumentet si më poshtë:

- Vendimet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
- Vendimet e privatizimit;

- Kontratat e lidhura midis palëve sipas dispozitave të Kodit Civil në R.Sh janë të vlefshme për përlllogaritjen e detyrimit të pronarit për Taksën e Ndërtesës.
- Dokumentat e tjera të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të pronësisë, sipërfaqja llogaritet sipas Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme (KVPP). KVPP dhe detyrat e funksionet e tij përcaktohen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë në zbatim të ligjit 9632/2006, i ndryshuar.

Detyrimi është vjetor. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive është si vijon:

	Qyteti Tirane (NJA 1-11) dhe NJA :Dajt, Farke, Kashar,	NJA: Berzhite, Baldushk, Vaqarr, Peze Petrele, Ndroq, Krabe, Shengjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar
Lekë /m2/vit		
I. Ndërtesa banimi		
- ndërtuar para 1993	15	7.5
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993	30	15
II. Ndërtesa të tjera		
- Ndërtesa për tregti dhe shërbime		
➤ Ndërtesa per BV	280	200
➤ Ndërtesa per BM+VIP	440	200
- Ndërtesa të tjera	100	50
- Ndërtesa prodhimi	200	50
III. Për pronësi më shumë se një banesë		
- ndërtuar para 1993	30	15
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993	60	30
IV. Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.	440	440

➤ *Ndërtesa banimi*

Nënkupton banesën në pronësi ku taksapaguesi ka banimin e zakonshëm.

Në nënkategorinë II “Ndërtesa të Tjera” përfshihen:

➤ *Ndërtesa për tregti dhe shërbime*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në pronësi të subjektit që e ka vënë në dispozicion për aktivitete si: hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje turizëm familje, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, bankat, zyrat, njësi regtare dhe ndërtesat për shërbime si: farmaci, klinika, spitale, maternitete, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve dhe njësitë e shërbimit artizanal si marangoz, këpucar, orë ndreqës, etj të ngjashme to). Shkollat, kopshtet, cerdhe, qendra kulturore, qendra sociale, stadione, komplekse sportive si palestra,

fitnes, pishina të hapura e të mbyllura, ndërtesa shkencore si institute kërkimore, qendra kërkimore, interneti, sallate koncerteve, videoteka etj.

➤ *Ndërtesa të tjera*

Do të përfshihen ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat e njohura ose të regjistruara si të tilla në gjykatë si dhe objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit, pasuri (njësi shërbimi) që nuk shfrytëzohen.

➤ *Ndërtesa prodhimi*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, naftë etj, shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

Rastet kur banesa (apo një pjesë e saj) ndryshon destinacionin nga banim në veprimtari ekonomike (apo të tjera) detyrimi për sipërfaqen që ndryshon destinacionin paguhet jo më si ndërtesë banimi, por sipas nënkategorisë “ndërtesa për tregti dhe shërbime”.

➤ *Ndërtesa në pronësi më shumë se një banesë*

Tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës, ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë, sipas klasifikimit në ndertime para 1993 dhe mbas vitit 1993.

➤ *Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.*

Ne kete nenkategori perfsihien ndertesat e ndertuara ne zonat me perparesi turizmi te miratuara si te tilla.

Per ndertesat ne pronesi te shoqerive te ndertimit, te destinuara per shitje, por qe jane ende te pashitura, taksa do te vendoset sipas destinacionit te perdorimit te ambjentit te nderteses. Ambjente e regjistruara ne ZRPP, si:

- Aparatamentet e banimit do ti nenshtrohen takses mbi ndertesat ne kategorie “Ndertesat banimi”
- Ndertesat per biznes do ti nenshtrohen takses mbi ndertesat ne nekategorie “Ndertesat te tjera per tregti dhe shërbime

Menyra e pageses

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.

Për kategoritë I dhe III, detyrimi paguhet në 2 këste.

- Kësti i parë paguhet brenda datës 30 Prill,
- Kësti i dytë paguhet brenda datës 30 Shtator.

Për kategoritë II dhe IV detyrimi paguhet me 2 këste.

- Kësti i parë paguhet brenda datës 20 Prill
- Kësti i dytë brenda datës 30 Qershor.

Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Lehtësira dhe përjashtime:

Taksapaguesit, për Kategorinë e pikës I të cilët paguajnë të gjithë vlerën e detyrimit tatimor vjetor brenda datës 30 Prill, përfitojnë si kusht lehtësues reduktimin në masën prej 10 % të vlerës së detyrimit.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qera të paliberalizuara;
- c) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare;
- d) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.

“Agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për kategorinë I “Ndërtesa Banimi”, kategorinë III “Ndërtesa më shumë se një banesë” dhe kategorinë IV “Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike”, kur përdoren për qëllim banimi, është Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A, ndërsa për të gjithë subjektet e tjera (shtetërore dhe private) strukturë e ngarkuar është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Mbeshtetur në ndryshimet ligjore, në këtë paketë taksa mbi ndërtesën ka pësuar disa ndryshime që reflektojnë politat e bashkise për lehtësimin e barres fiskale të disa kategorive të biznesit sipas llojit, aktivitetit dhe vendndodhjes së tyre.

Me konkretisht, është propozuar përgjysmimi i nivelit të taksës për njesitë periferike, ulja e nivelit për ndërtesat e biznesit të vogël me -30%, rritja me 10% e nivelit të taksës për bizneset e mëdha dhe përgjysmimi i taksës për qëllime prodhimi.

Ky kategorizim, do krijoj lehtësira kryesisht për BV, me ulje të barres fiskale me qëllim zgjerimin e aktivitetit dhe njekohesisht për rritjen e punësimit.

Kjo takse do të arketohet nga agjenti tatimor UKT Sha. Bashkia e Tiranës, ngarkohet të lidhë akt-marreveshje me agjentin tatimor të taksës së ndërtesës, ku të përcaktohen rregullat dhe mënyrën e vjeljes së taksës së ndërtesës për kategorinë e familjarëve; në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjithashtu në këtë akt-marreveshje përcaktohen afatet e kalimit të të ardhurave si dhe informacione të specifikuar lidhur me familjet paguese dhe debitore si dhe problematikat e arketimit.

I.a.2 TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë pronësinë.

Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, njihen dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në rast mungese të dokumentacionit ligjor verifikimi bëhet nga komisioni i verifikimit të pasurive të paluajtshme i ngritur për këtë qëllim.

Niveli i taksës sipas kategorive është si vijon:

Kategoritë e tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	5 600
II	4 900
III	4 200
IV	3 600
V	3 000
VI	2 400
VII– X	1 800

Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Lehtësira dhe përjashtime:

- Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
- Aplikohet -30% e taksës për tokat bujqësore mbi të gjitha sipërfaqet e përdorura për qëllime bujqësore.

“Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës në bashkëpunim me “Njësinë Administrative”. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë”.

Krahas përjashtimeve ligjore të përcaktuara për këtë taksë, për stimulimin e subjekteve për aktivizimin e tokës për qëllime bujqësore, rritjen e prodhimit bujqësor dhe të punësuarve në këtë sektor, propozohet një ulje prej 30% për të gjithë poseduesit që e zhvillojnë tokën bujqësore.

I.a.3 TAKSA MBI TRUALLIN

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në m², në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në tabelën e mëposhtme.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

Niveli i taksës së taksës së truallit (jo hapsirë publike), është si vijon:

	Vlera e taksës në lekë/m ² /vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m ² /vit, për qëllime biznesi
Bashkia Tiranë	0.56 lek/m ²	20 lekë/m ²

Kjo takse vjen në kuadër të politikave kombëtare për taksimin, si pjesë e taksës mbi pronësinë dhe trajtohet në të njëjtën mënyrë si dhe taksa mbi ndërtesën.

Qëllimi i saj është evidentimi dhe nxitja e shfrytëzimit të truallit në mënyrë sa më efektive dhe jo abuzuese, duke evidentuar sipërfaqet e shfrytëzuesë pjesë e banesës dhe sipërfaqet për aktivitet ekonomik dhe për të kufizuar në maksimum abuzimin me trojet me betone, ndërtime të paligjshme e jo funksionale, etj mënyra që e demtojnë ato.

I.b TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Sipas përcaktimeve në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), çdo biznes, i cili realizon gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Niveli i tatimit për subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë, është 0 (zero) lekë.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim nga 5 deri në 8 milionë lekë, është 5 për qind mbi fitimin e tatueshëm.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Periodha bazë që duhet të merret parasysh për llogaritjen e qarkullimit është viti kalendarik, që do të thotë periodha nga 1 janari deri në 31 dhjetor. Në çdo rast, në qoftë se gjatë vitit kalendarik, qarkullimi tejkalon ose parashikohet të tejkalojë kufirin prej 8 milionë lekë, personi fizik ose juridik detyrohet të regjistrohet si tatimpagues i tatimit mbi fitimin.

Qarkullimi që merret parasysh është qarkullimi gjithsej i realizuar nga i njëjti person, pavarësisht nga statusi i tij. Në qoftë se një person ka disa veprimtari në të njëjtin vend ose në vende të ndryshme, qarkullimi që merret për bazë përfshin qarkullimin e të gjitha veprimtarive, në të gjitha vendndodhjet ku zhvillohet ajo.

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to, *të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.* Të ardhurat e tatueshme apo fitimi i tatueshëm rezulton si diferencë e të ardhurave gjithsej të realizuar gjatë periudhës tatimore me shpenzimet e njohura.

Gjithashtu edhe kjo taksë vjen në kuadër të politikave kombëtare për lehtësimin e barrës fiskale të subjekteve biznesi të vogël dhe nxitjen e vetpunësimit.

I.c TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Baza e taksës së fjetjes në hotel, është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë. Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistikë, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

Niveli i taksës sipas kategorive, është si vijon:

Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tiranë Kashar, Dajt, Farka	Niveli i taksës
Subjekte hoteleri me 4-5 yje	350 leke per cdo fjetje
Subjekte hotele, bujtine, fjetinë, motel, dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	140 lek leke per cdo fjetje

Për të gjitha Njësitë Administrative të tjera në Bashkinë e Tiranës aplikohet niveli 140 lek leke per cdo fjetje.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës në bashkëpunim me Njësitë Administrative. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë.

Në kuadër të politikave kombëtare për promovimin e turizmit, është miratuar ndryshimi i taksës së fjetjes në hotel. Ndryshe nga niveli ekzistues, ndaj këtyre subjekteve do të aplikohen nivele me vlera absolute fikse dhe jo në përqindje.

Paketa e re fiskale, pasqyron dhe ndryshimin e niveleve për subjektet hoteleri me 4-5 yje dhe subjektet hoteleri, si hotele, bujtina, motele, fjetina etj që kanë aktivitet relativisht me të vogël se hotelet luksoze me kushte me të mira akomoduese.

I.d TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës, është si vijon:

1. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.
2. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe për Bashkinë e Tiranës është 2 deri 4 për qind e saj.
3. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
4. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.”.

Taksa paguhet brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes për punime dhe lëshimit të autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Në rast se kërkuesi nuk kryen pagesën brenda 5 ditëve pune nga njoftimi për detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet kamata 0,2 për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 30 ditë pune. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, Kryetari i Bashkisë vendos masa të tjera të përshtatshme, deri në revokimin e vetë lejes së miratuar.

Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar të shlyejë. Mosshlyerja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullimin e procedurave të paisjes me leje përdorimi të subjektit”.

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe të ardhurat arkëtohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Niveli i rikonceptuar i taksës t’i jepë një mundësi reale Bashkisë Tiranë për të realizuar një politikë nxitëse/shkurajuese për zhvillimin e zonave të caktuara të qytetit.

Të ardhurat shtesë nga kjo taksë do t'i mundësojnë Bashkisë Tiranë ti përgjigjet me infrastrukturë ndërtimeve të reja.

I.dh TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës sipas kategorive, është si vijon:

		Lekë/m ²
	Qyteti Tiranes, NJA = Dajt, Farke, Kashar	NJA = Berzhite, Baldushk, Vaqarr, Petrele, Peze, Ndroq, Krabe, Shengjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar (-30%)
I. Ndërtesa banimi	1000	700
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2000	1400
II. Ndërtesa të tjera	1500	1050

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";
- c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - ii. bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose komunal për përjashtimin nga taksë, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme cila në rolin e agjentit të taksës përfitonë 3 % të shumës së arkëtuar.

Për 10 Njësitë Administrative që shtrihen më larg qendrës së qytetit është propozuar aplikimi i lehtësisë nëpërmjet uljes së nivelit të taksës me -30% krahasimisht me Njësitë e tjera.

I.e. TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime reklamimi.

Tabelë për qëllime identifikimi është tabela, brenda ose jashtë territorit ku zhvillon aktivitetin biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë ose jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim. Taksa e tabelës paguhet për cdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKR.

Në kategorinë e tabelës për qëllime reklamimi (të lëvizshme dhe të palëvizshme) kuptojmë të gjithë tabelat të vendosura në pamje jo ballore, të vendosura në tarraca, llozhe, ballkone, të vendosura në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje reklamimi për vete ose të tretë.

Në kategorinë e tabelave në funksion apo ekspozime të ndryshme të hapura do të kuptojmë të gjithë ato tabela në funksion të panairëve të ndryshme etj. që kanë si qëllim reklamimi për vete ose për të tretët.

Niveli i taksës sipas kategorive paraqitet si me poshte:

KATEGORITE	Qyteti Tirane, NJA = Dajt, Farke, Kashar,	NJA = Berzhite, Baldushk, Petrele, Vaqarr, Peze, Ndroq, Krabe, Shengjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar (-30%)
1) Tabelë për qëllime identifikimi:		
a) Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 m ²	0 (zero)	0 (zero)
a.1 Tabela për qëllime identifikimi mbi 2 m ² .	45.000 lekë/m ² /vit	31.500 lekë/m ² /vit
b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	120 leke /vit	120 leke /vit
2) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:		
a) Për Bashkinë e Tiranës	45 000 lekë/m ² /vit	31.500 lekë/m ² /vit.
a.1) Tabelë e thjeshtë	90 000 lekë/m ² /vit	63.000 lekë/m ² /vit
a.2) Tabelë elektronike		
3) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj. <i>(Tabela, banderola, spote etj te ngjashme me to</i>	1.000 lekë/m ² /ditë	1.000 lekë/m ² /ditë

“Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës, është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës në bashkëpunim me “Njësinë Administrative”. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës

Taksa reflekton ndryshimet e fundit ligjore dhe nuk janë propozuar ndryshime për nivelin e aplikimit të kësaj takse nga Bashkia e Tiranës.

I.f TAKSA E PËRKOHSHME PËR INFRASTRUKTURËN ARSIMORE

Taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive është si vijon:

Nr	Kategorite	Niveli i Takses		
		Viti 2016		
		BV	BM	VIP
		Leke /vit	Leke /vit	Leke /vit
I	Familjaret	1.800		
II	Biznesi			
II.1	Shitje me pakicë	4.000	15.000	22.000
II.2	Shitje me shumicë	9.000	27.000	37.000
II.3	Njesi prodhimi	9.000	27.000	37.000
II.4	Subjekte ndertimi	9.000	27.000	37.000
II.5	Njesi sherbimi	4.000	17.000	32.000
II.6	Shoqata, fondacione, ente të ndryshme shtetërore, organizata joqeveritar	5.000		
II.7	Profesione te lira	4.000	15.000	18.000
II.8	Transport	4.000	11.000	18.000

Mënyra e pagesës është si më poshtë:

Detyrimi për taksën e përkohshme për infrastrukturën arsimore është vjetor.

Kjo takse do te aplikohet për një periudhë 7 vjecare

Për kategorinë I. “Familjarë” detyrimi paguhet brenda datës 30 Prill të vitit. Për çdo familje të krijuar rishtaz, afati i pagesës së taksës do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile të Njësisë Administrative përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Për kategoritë II. “Biznesi” detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR.

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal)

Lehtësirat:

Kategoritë e përjashtuara nga pagesa e taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore, ku përfshihen pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbërit dhe të sëmurët tetraplegjik e paraplegjikë, për të mundësuar këtë përjashtim, duhet të dorëzojnë pranë zyrave të strukturës tatimore dëshminë e gjendjes së tyre dhe konkretisht:

- Dokumentin që vërteton kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare.
- Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës e të luftës, statusin e të verbërit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit dhe vërtetimin nga Njësia Bashkiake për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Të ardhurat e arketuara nga kjo takse do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo takse, për rikonstruksionin e shkollave dhe gjithë infrastrukturës arsimore të Bashkisë së Tiranës.

Agjenti tatimor i ngarkuar për mbledhjen e taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore për kategorinë “Familjarë” është Ujësja e Kanalizimeve Sha, ndërsa për të gjithë subjektet e tjera (shtetërore dhe private) strukturë e ngarkuar është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore do të jetë një taksë e përkohshme, e cila do të mbledhet vetëm për 7 vjet do të zëvendësojë taksën e përkohshme të gjelbër. Kjo taksë do t'u kushtojë familjeve vetëm 1800 lekë në vit ose 150 lekë në muaj. Sigurisht, që pensionistët, familjet në ndihmë ekonomike apo shtetasit e tjera në nevojë do të përjashtohen nga kjo taksë. Për biznesin kjo taksë do të variojë në bazë të të ardhurave, nga 4000 lekë në vit për biznesin e vogël deri në 37000 lekë në vit për biznesin e madh dhe atë VIP.

Të ardhurat nga kjo taksë do t'i dedikohen vetëm infrastrukturës arsimore dhe do të ndihmojë të realizojmë një nga projektet më të mëdha dhe me imapktin më të lartë social për Bashkinë Tiranë, duke hequr përfundimisht mësimin me dy turne në shkollat e Tiranës.

II. TARIFAT VENDORE

II.a TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe janë si më poshtë:

Nr	Kategorite	BV		BM	VIP
		Xhiro 0-2 milion	Xhiro 2-8 milion		
		Leke/vit	Leke/vit		
FAMILJARET (për Familje)					
I	Qyteti Tiranes	5,000			
	NJA = Dajt, Farke, Kashar,	2,000			
	NJA = Berzhite, Baldushk, Petrele, Vaqarr, Peze, Ndroq, Krabe, Shengjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar	1,000			
II	BIZNESI				
II.1	SHITJE ME PAKICË				
	Mish, peshk	3,500	10,000	80,000	100,000
	Bulmet, Fruta, perime, ushqimore	3,500	10,000	60,000	81,000
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj të ngjashme me to).	3,500	10,000	30,000	50,000
	Bar kafë	3,500	10,000	60,000	80,000
	Restorant, fast food etj te ngjashme me to	3,500	12,000	74,000	94,000
	Pub, diskoteka etj te njashme	3,500	12,000	80,000	100,000
	Vendosje tavolina ne muaj në hapësirat publike për tavolinë. Per subjektet (bar, kafe, restorant, fast food, kafe internet etj te ngjashme me to).	2,500			
	Kafe internet, lojëra fati, qendra interneti	3,500	10,000	20,000	38,000
	Njesi tregtimi lendesh djegese, hidrokarbure etj te ngjashme me to.	3,500	10,000	44,000	64,000
	Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to (depo farmaceutike te regjistruara si biznes i vogël)	3,500	10,000	20,000	38,000
	Etj te ngjashme me to	3,500	10,000	20,000	38,000
II.2	SHITJE ME SHUMICË				
	Magazina, dyqane, etj te cilat realizojnë shitje me shumice	3,500	12,000	74,000	94,000
II.3	NJESI PRODHIMI				
	Perpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj te ngjashme me to	3,500	10,000	170,000	360,000
	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje, nyje inerte etj. te ngjashme me to	3,500	10,000	170,000	360,000
	Prodhime ushqimore, buke, embelsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj te ngjashme me to.	3,500	10,000	170,000	340,000
	Prodhim konfeksione, etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Prodhim, perpunim vajrash, naftë , gazi e nenprodukte etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Impiante, territore per therrjen e kafshëve etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Shtypshkronja etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Impiante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera.	3,500	7,000	170,000	360,000
	Prodhim perpunim produkte farmaceutike etj te ngjashme me to.	3,500	7,000	170,000	360,000
II.4	SUBJEKTE NDERTIMI				

	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to .	3,500	30,000	300,000	450,000
	Rikonstruksione te pjeseshme	3,500	15,000	150,000	224,000
	Subjekte Ndertuese per selinë administrative	3,500	15,000	36,000	60,000
	Subjektet e Karrierave per prodhim gurri, inerte etj te ngjashme me to,	3,500	15,000	100,000	100,000
II.5	NJESI SHERBIMI				
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizore, frigorifere, lavatriçe, manjetofon, paisje fonie e te tjera te ngjashme me to.	3,500	10,000	50,000	60,000
	Sherbime fotokopimit, sallon bukurie, autoservise, kurse per makina (autoshkolla) per traktore, per kompjuter e per parukeri, agjensi doganore, agjensi kembimi valute, agjensi turizmi,, konviktet pikat e sherbimit te makinave (autoservis), parkimi i makinave, agjenci transporti, lavanterite, pastrimi kimik, sherbime te rojeve civile, sallat e lojrave te ndryshme (gjimnastike, aerobie, cirqe, kende lojrash per femije, ping pong, etj.) e te tjera sherbime te ngjashme me sherbimet e lartepmendura.	3,500	10,000	50,000	70,000
	Shtëpi botuese, biblioteka	3,500	10,000	50,000	70,000
	Hotele, motele (leke/dhome ne vit)	3,500	10,000 + 1.000	30,000 +1.500	60,000 +2.000
	Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës,këpucar, floktore, orëndreqës etj	3,500	7,000	30,000	50,000
	Komplekse sportive, palestra, fitnes,pishina, qendra e institute kerkimore-shkencore,salla koncerte-mbledhje e videoteka	3,500	10,000	50,000	70,000
	Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura	3,500	10,000	20,000	50,000
	Institucionet jopublike te edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet), shërbimet ne klinikat e specialiteteve te ndryshme mjekësore, shërbimet ne laboratorë diagnostifikimi	3,500	10,000	50,000	70,000
	Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)	3,500	10,000	30,000	50,000
II.6	SHOQATA, FONDACIONE, ENTE TE NDRYSHME SHTETERORE, ORGANIZATA JOQEVERITARE		10.000		
II.7	PROFESIONE TE LIRA				
	Avokatet, noter,mjek, mjeku-laborant, stomatologu, Farmacisti, ekonomisti kontabël te miratuar, eksperti kontabël te autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomit, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e te tjera profesione te lira te cilat ushtrohen ne njësi fikse apo ne ambiente te ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	3,500	10,000	30,000	50,000
	Galeritë e artit te piktoreve, skulptoreve dhe artisteve te tjerë qe prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	3,500	10,000	30,000	50,000
	Institucionet jopublike te edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet), , shërbimet ne klinikat e specialiteteve te ndryshme mjekësore, shërbimet ne laboratorë diagnostifikimi etj ne rastet kur nuk e kalojnë kufirin e regjistrimit ne TVSH.	3,500	12,000	50,000	70,000
II.8	AMBULANT				
	Subjekte qe nuk kane një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante ne tregje publike dhe private.		3.000		
II.9	TRANSPORT				
	Transport pasagjerësh				
	Automjet deri 5 vende	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet 6-9 vende	3,500	7,000	20,000	48,000

	Automjet 10-25 vende	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet 26-42 vende	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet mbi 42 vende	3,500	7,000	20,000	48,000
	Transport Mallrash				
	Automjet deri 2 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet 2-5 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet 5-10 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet 10-16 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000
	Automjet mbi 16 tonë	3,500	7,000	20,000	48,000

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën e pastrimit është vjetor.

Për kategorinë I “Familjarët” detyrimi paguhet në 2 këste. Kësti i parë paguhet brenda datës 30 Prill, Kësti i dytë paguhet brenda datës 30 Shtator. Për çdo familje të krijuar rishtaz, afati i pagesës së tarifës së pastrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile të Njësisë Bashkiake përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Për kategorinë I “Familjarët” detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën kjo kategori duhet të paraqesë pranë agjentit tatimor përkatës certifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

Për kategorinë II. “Biznesi” detyrimi paguhet brenda datë 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKR. Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal).

Për kategorinë II. “Subjekte Ndërtimi” nënkategorinë “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to” “Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla kopshte, objekte banimi e tregtare, etj të ngjashëm me to”, llogaritja e tarifës së pastrimit të filloje me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për leje shfrytëzimi pranë Bashkisë së Tiranës. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit.

Të ardhurat e krijuara nga tarifata e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

Agjenti tatimor ingarkuar për mbledhjen e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë “Familjarë” është Ujësjellës-Kanalizime Sha, duke përfutur 5 % të shumës së arkëtuar, ndërsa për të gjithë subjektet e tjera (shtetërore dhe private) strukturë e ngarkuar është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Lehtësirat:

Kategoritë e përjashtuara nga pagesa e taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore, ku përfshihen pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfutuesit e ndihmës ekonomike,

të verbërit dhe të sëmurët tetraplegjik ë paraplegjikë, për të mundësuar këtë përjashtim, duhet të dorëzojnë pranë zyrave të strukturës tatimore dëshminë e gjendjes së tyre dhe konkretisht:

- Dokumentin që vërteton kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare.
- Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës e të luftës, statusin e të verbërit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit dhe vërtetimin nga Njësia Bashkiake për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Tarifa e pastrimit do të mbetet në të njëjtin nivel për kategorinë familjarë dhe biznese të vogla dhe do të ketë një rritje për kategorinë e bizneseve të mëdha dhe VIP. Të ardhurat nga kjo taksë synohet të mbulojnë shërbimin e pastrimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane në qytet, i cili me përmasat e reja të Tiranës pritet të ketë një peshë shumë të madhe në buxhet në periudhat në vijim.

Diferencimi i taksës dhe detajimi i saj në kategori biznesesh dhe lloje aktiviteti siguron një drejtësi fiskale në raport me masën e ndotjes në ambient dhe krijimit të mbetjeve urbane që krijojnë aktivitete të llojeve të ndryshme

II.b TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m² e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

Niveli i tarifës sipas kategorive dhe nënkategorive është si vijon:

KATEGORIA DHE NËNKATEGORITË	NIVELI TREGUES I TAKSËS/MUAJ			
	ZONA A	ZONA B	ZONA C Qyteti Tirane, NJA= Dajt, Farke, Kashar	NJA = Berzhite, Baldushk, Petrele, Vaqarr, Peze, Ndroq, Krabe, Shengjergj, Zall- Herr, Zall-Bastar
Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli)				
Nënkategoritë				
Organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme	1500 ALL/m ²	750 ALL/m ²	400 ALL/m ²	200 ALL/m ²
Zënia e Hapësirës publike për qëllime biznesi/tregtimi në Tregjet Publike të administruara nga Njësitë Bashkiake.	1500 ALL/m ²	750 ALL/m ²	400 ALL/m ²	200 ALL/m ²
Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.	1500 ALL/m ²	750 ALL/m ²	400 ALL/m ²	200 ALL/m ²

Detyrimi i tarifës për llogaritjet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.

Pagesa e Tarifës për zënie të hapësirës publike:

a) Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme, struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, pa smarrjes së Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit, nga struktura përkatëse që jep edhe lejet për ushtrim aktiviteti në Bashkinë e Tiranës. Kjo strukturë kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse.

b) Për rastin e përdorimit të truallit qëllim ushtrim aktiviteti tregtar në Tregjet Publike të Tiranës, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore”, në bashkëpunim me “Njësinë Administrative”. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë.

c) Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqet e rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore

Lehtësirat:

- Lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5% të vlerës së detyrimit.
- lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës për zënie të hapësirës publike, është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me “Njësinë Administrative”. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë”.

Kthimi i taksës së hapësirës publike në tarifë është bërë është një zhvillim pozitiv pasi iu lë më shumë diskrecion e bashkive për mirëmenaxhimin e hapësirave publike nën juridiksionin e tyre. Kjo për arsye se zënia e hapësirave publike për qëllime biznesi është një lloj qiradhënie e hapësirave bashkiake për bizneset, dhe duhet të jetë nën kompetencën e vet Këshillave Bashkiake, të cilët njohin me mirë pasuritë publike të tyre, zonat ato zotërohen si dhe të përcaktojnë nivelet e tarifimit. Kjo do të shërbejë edhe si një stimul për vet Këshillat Bashkiake në politikën e tyre të përdorimit dhe eficientës së përdorimit të hapësirave publike.

II.c TARIFA PËR DHENIE LICENCE PËR TREGTIM KARBURATI E LENDE DJEGESE.

Niveli i tarifës dhe kushtet për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, përcaktohen me VKM nr.970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e

procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Qellimi i miratimit të kësaj tarife është rregullimi i tregut të karburanteve dhe lëndjeve djegëse, për një shpërndarje racionale dhe një miradministruar të territorit duke shmangur ngritjen e pikave të tregimit të tyre në afersi të ndërtesave të banimit, qendrave arsimore dhe institucioneve.

Organet që kanë përgjegjësi për dhënien e licencave, sipas këtij kreu, ushtrojnë kontroll për të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacionin e personit juridik kërkuar.

Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve për automjetet, gazit të lëngshëm, të naftës, dhe vajrave lubrifikante në territorin e Bashkisë Tiranës është 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndjeve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, në territorin e Bashkisë Tiranës është 1.000.000 (një milion) lekë.

Të ardhurat, që realizohen nga pagesat e tarifave, përdoren në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, sipas përcaktimeve përkatëse.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës për dhënie dhe përsëritjen e licencave për tregtim karburanti, lende djegëse e vajra lubrifikant është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, pas marrjes së Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit, nga struktura përkaëse që jep edhe lejet për ushtrim aktiviteti në Bashkinë e Tiranës. Kjo strukturë kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse.

II.d TARIFA E SHERBIMIT VETERINAR

Tarifa është një detyrim fikse që aplikohet nga shërbimi veterinar për të gjithë kategoritë sa më poshtë:

- Subjekte me aktivitet thertorë;
- Subjekte me aktivitet pikë therje;
- Treg i gjësë së gjallë.

	Kategoritë e aktiviteteve të kontrollit	Kontrolli	Tarifa e percaktuar
1	Kontrolli i mishit dhe pajisja me raport veterinar për kre gjedh i rritur, gjedh i ri, (lopë, ka, mëshqerrë, viç	- Vizitimi para therjes. (gjëndja shëndetësore e kafshës së gjallë) - Kontrolli gjatë dhe pas therjes. (egzaminim dhe vlerësim organo-leptik i karkases). - Vulosja, plotësimi i dokumentacionit veterinar	500 lekë (për çdo kre)
2	Kontrolli i mishit dhe pajisja me raport veterinar për një kre bagëti të imta (dash, dele, çjap, dhi, derr, rurza, milorë, ftuja, tujakë, qingj, keç, gic).	- Vizitimi para therjes. (gjëndja shëndetësore e kafshës së gjallë) - Kontrolli gjatë dhe pas therjes. (egzaminim e vlerësim organo-leptik i karkasës) - Vulosja, plotësimi i dokumentacionit	200 lekë (për çdo kre)

3	Shërbim veterinar në tregun e gjësë së gjallë	veterinar	500 lekë (për çdo kre)
		- Rregjistrimi i dokumentacionit shoqërues për çdo bagëti të gjallë. - Lëshimi i certifikatës për lëvizjen e kafshëve	

Tarifat e mësipërme do të arketohen nga Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Tarifa e shërbimit veterinar, propozohet bazuar në Ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 , për “Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore” (i ndryshuar). Ky ligj dhe dhe VKM nr. 230, date 20.3.2013 “Për Përcaktimin e Funksioneve, Detyrave Specifike dhe Standarteve të Shërbimit Veterinar të Qeverisjes Vendore”, qartëson kompetencat e Shërbimit Veterinar në Njësitë e Qeverisjes Vendore.

- Shërbimin veterinar për nevojat e popullsisë dhe kontrollin veterinar në thertore, tregun e kafshëve,
- Shërbimet e tjera veterinare që kanë të bëjnë me kontrollin e dyqaneve të tregëtimit të kafshëve të shoqërimit.
- Monitorimi i subjekteve të therjes dhe tregëtimit të mishit të freskët.

Për qëllime të rritjes së efektivitetit të kontrollit veterinar në funksion të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorëve, propozohet që monitorimi fushën e shërbimeve veterinare të shoqërohet me tarifat e mësipërme.

TARIFA TË TJERA

Tarifat që prezantohen më poshtë janë tarifa të llogaritura mbi kostot e ofrimit të shërbimeve respektive dhe kanë qëllim mbulimin e shpenzimeve për këto shërbime. Këto tarifa janë të prezantuara në paketë prej disa vitesh dhe nuk paraqiten me ndryshime.

II.dh TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV TË BASHKISË TIRANË

II.dh.1 TARIFA TE SHERBIMIT TE DREJTORISE SE PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

1. Tërheqje dokumentash dhe njehsim me origjinalin nga Drejtoria e Arkivit Qendror dhe protokollit dhe Sektori i GIS Kadastra

100 lekë / dokument

2. Kontrolli i piktimit të objekteve

- për objekte deri në 3 kate mbi tokë
- mbi 3 kate mbi tokë

3.200 lekë

4.800 lekë

3. Kontrolli pas përfundimit të themeleve

- për objekte deri në 3 kate mbi tokë
- mbi 3 kate mbi tokë

3.200 lekë

4.800 lekë

4. Kontrolli pas përfundimit të karabinasë

2.000 lekë për kat

Tarifa paguhet brenda 5 ditëve nga data e aplikimit dhe lëshimit të autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Subjektit nuk i miratohet vendimi për lejen përkatëse, nëse nuk paraqet vërtetimin e kryerjes së pagesës brenda afatit të sipërpërmendur. Tarifa e paguar i kthehet aplikuesit në rastin e mosmiratimit të lejes.

Përrjashtohet nga pagesa e kësaj tarife Bashkia e Tiranës në rolin e investitorit të objekteve publike”.

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e urbanistikës është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe arkëtimi kryhet sipas autorizimit të lëshuar për këto qellime, pranë bankave të nivelit të dytë ose pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore e cila edhe konfirmon arkëtimin e detyrimit.

II.e TARIFA TË INSTITUCIONEVE TËVARËSISË

II.e.1 TARIFA NE DREJTORINE E PERGJITHSHME TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

1. Dhënia e vërtetimit të pagesës për taksat dhe tarifën vendore	200 lekë
2. Komisione për shërbimin të arka	100 lekë
3. Përfitim reduktimi të taksës familjare	200 lekë
4. Përfitim përjashtimi nga taksa e pastrimit dhe pagesa UKT (pensionistë/invalidë).	200 lekë

Struktura e ngarkuar për lëshimin e dokumentit dhe arkëtimin e pagesës është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

II.e.2 TARIFA NE AGJENCINE E PARQEVE DHE REKREACIONIT

- Hyrja në Kopshtin Zoologjik:	përfëmijë	50 lekë/ hyrja
	përtë rritur	100 lekë/ hyrja

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit dhe sipas aktit rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat kalojnë në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

II.e.3 TARIFA NE QENDRAKULTURORE “TIRANA”

Për çfaqjet e lira për publikun	200 lekë/ hyrja
Hyrja për shfaqjet e varietes :	
a) Në llozhë	500 lekë/ hyrja
b) Në aneks llozhë	300 lekë/ hyrja
c) Në anësore	200 lekë/ hyrja

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Qendra Kulturore “TIRANA” dhe sipas aktit rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat kalojnë në llogarinë e Bashkisë së Tiranës..

II.e.4 TARIFA NE KLUBINSPORTIV TIRANA

- Tarifa e përdorimit të fushave të tenisit 300 lekë/orë

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Klubi Sportiv Tirana dhe sipas akt rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat kalojnë në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

II.e.5 TARIFA NE QËNDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa :

Lloji i tarifës	Në kopshte	Në çerdhe
Tarifë për Ushqimin		
Qyteti Tirane	160 lekë/ditë/fëmijë	130 lekë/ditë/fëmijë

Detyrimi mujor përbëhet nga Tarifa për Ushqimin, e cila llogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe/kopsht gjatë 1 muaji.

Përfitojnë reduktim të detyrimit mujor ose shërbim pa pagesë kategoritë e më poshtme:

1. Familjet, të cilat kanë më shumë se 1 fëmijë në çerdhe dhe/ose kopshte:

- 1.1 për fëmijën e dytë 50 % reduktim nga detyrimi mujor
- 1.2 për fëmijën etretë 100% reduktim nga detyrimi mujor

2. Familje në nevojë si më poshtë përfitojnë shërbim pa pagesë:

- 1.1 Fëmijë me aftësitë kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda (sëmundje gjaku, sëmundje të brendshme), sipas raportit të Komisionit Mjeko-Ligjor.
- 1.2 Fëmijëtë vajzave-nëna, sipas statusit në regjistrat e Gjendjes Civile.
- 1.3 Fëmijët e familjeve, ku kryefamiljare është gruaja e ve (sipas çertifikatës së gjendjes familjare), familjet ku kryefamiljare është gruaja e divorcuar (sipas çertifikatës së gjendjes familjare), por që është në/nën pagën minimale në shkallë vendime dokumentacionin përkatës.
- 1.4 Fëmijë të familjeve ku kryefamiljari është me pa aftësi fizike ose mendore sipas raportit të Komisionit Mjeko-Ligjor.
- 1.5 Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe sipas akt rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat kalojnë në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

Për sa më sipër, relacioni dhe projekt vendimi i paraqitet për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak të Tiranës, me qëllim reflektimin e efekteve të ndryshimeve ligjore në Paketën Fiskale të Bashkisë së Tiranës.

Duke shpresuar në miratimin Tuaj.

Jonida Halili

Drejtor i Përgjithshëm i Deleguar, Drejtoria e Menaxhimit Financiar



Arli Naska


Drejtori i Pergjitheshem i Taksave dhe Tarifave Vendore

Itena Ndroqi

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria Juridike e Aseteve dhe Licensimit

Arbian Mazniku

Zv. Kryetar



Arsela Gjonaj
Juristi i Këshillit Bashkiak

Behar Zeneli
Sekretar i Këshillit Bashkiak



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

Lënda: Dërgim relacioni për Këshillin Bashkiak

Bashkëlidhur, në Këshillin Bashkiak, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, është dërguar për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi dhe relacioni për “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Tiranës”.

Sekretar

Behar Zeneli

Juriste

Arsela Gjonaj